



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/344

Datë: 02.08.2022

Procesverbal

i mbledhjes se -IV- të rregullt për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i kërkesës së kryetarit të Komunës Nr.01/819 datë: 26.05.2022, për iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Malishevës.
2. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i kërkesës së kryetarit të Komunës Nr.01/818 datë: 26.05.2022, për marrjen e vendimit për shpalljen e zonës private, zonë me interes publik me rastin e realizimit të projektit "Ndërtimi i rezervuarit të ujit të pijes në fshatin Janqisht" K.K.Malishevë.
3. Informimi mbi Qarkoren e parë buxhetore KAB-in.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i kërkesës Nr.01/489 datë: 04.04.2022, për miratimin e Projekt propozimit të Planit Vjetor të Punës së KKSBB-së për vitin 2022.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend, për miratimin e Propozim-Planit të punës për vitin 2022 të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Shqyrtimi i kërkesave.
7. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datën: 03.06.2022, filloj në ora 11.50, të pranishëm ishin 6 anëtarë të KPF-së, përfaqësuesi i zyrës për Informim, OSBE.

Argjend Thaçi: Ju përshëndes të gjithëve rendin e ditës e keni me material të mbledhjes e keni marrë tani për rend dite i kemi mi fute dy procesverbale atë të mbledhjes se 3 të rregullt dhe të 2 urgjente. Kush jeni për?

Unanimisht ishin të gjithë që këto dy pika të futen në rend dite.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i dy procesverbale atë të mbledhjes se 3 të rregullt dhe të 2 urgjente.

Argjend Thaçi: Kush jeni për miratimin e këtyre procesverbaleve? Unanimisht ishin për.

2. Informimi mbi Qarkoren e parë buxhetore KAB-in.

Sadik Vrenezi: Janë disa lëshime, por kur e sjellim në kuvend draft buxhetin këto do të rregullohen.

Hatixhe Kryeziu: Në qarkoren e punuar kemi kërkuar nga të gjitha njësitë dhe ju kemi dërguar drejtorive, deri tani nuk kemi pranuar asnjë propozim përveç Arsimit dhe shëndetësisë për staf shtesë që kanë kërkuar mjete shtesë, shëndetësia kanë kërkuar për mjek dhe infermier.

Argjend Thaçi: Si Kpf lidhur me qarkohen sa jam në dijeni duhet debat publik, përmes Zyrës për informim publik që para seancës së Kuvendit të inkorporohen të gjitha çështjet.

Hatixhe Kryeziu: Buxheti në kufijtë buxhetor ndryshon prej vitit në vit.

Sadik Vrenezi: Çka janë shërbimet rezidenciale.

Hatixhe Kryeziu: Kujdesi ndaj të moshuarve dhe ndaj personave më nevojë.

Rukije Bytyçi: Është menduar ndërtimi i një strehimore për personat me nevojë.

Veton Zogaj: Ky është një dokument i rëndësishëm që shkon krahas buxhetit, tani ka një performancë në të hyrat vetanake por apo reflektojnë borxhet në këto të hyra. Si kame pas rritje të buxhetit kur në Arsim ka zvogëlim të numrit të nxënësve, në shëndetësi se di pse numër më të madh. Dy çerdhet a kanë mirë me partneritet me komunitetin, Dka duhet me ba lëvizje krahas lëvizjes me numrin e nxënësve.

Argjend Thaçi: Kush jeni për rekomandimit të KAB për Kuvend? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i kërkesës së kryetarit të Komunës Nr.01/819 datë: 26.05.2022, për iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Malishevës.

Veton Zogaj: Në plan të punës në Shtator është paraparë, ky dokument prej vitit 2008 është i pa ndryshuar edhe pse ka pas nevojë për ta ndryshuar. Komisioni mirë është me kanë ekspert të fushës juridike.

Argjend Thaçi: Kush jeni për rekomandim të kësaj pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i kërkesës së kryetarit të Komunës Nr.01/818 datë: 26.05.2022, për marrjen e vendimit për shpalljen e zonës private, zonë me interes publik me rastin e realizimit të projektit "Ndërtimi i rezervuarit të ujit të pijes në fshatin Janqisht" K.K.Malishevë.

Sadik Vrenezi: Pse aty është ndërtuar, edhe si mund të kërkohej tash me shpallë zonë me interes kur aty është prerë shiriti për atë projekt.

Veton Zogaj: Të sqarohet sipërfaqja saktë, duhet një raport sa fshatra furnizohen, ose sa familje kanë përfituar nga aj ujjësjellës, pse Komuna e ka ndërtuar në pronë private pa e shpronësuar, sa mjete janë investuar aty.

Argjend Thaçi: Nëse projekti ka qenë i nevojshëm atëherë kërkesën e kryetarit duhet ta procedojmë për kuvend.

Kush jeni për rekomandim të kësaj pikë për Kuvend? Për ishin 3, kundër 2, abstenime 1.

5. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i kërkesës Nr.01/489 datë: 04.04.2022, për miratimin e Projekt propozimit të Planit Vjetor të Punës së KKS-së për vitin 2022.

Argjend Thaçi: Kush jeni për rekomandim të kësaj pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

6. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend, për miratimin e Propozim-Planit të punës për vitin 2022 të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Veton Zogaj: Puna e Komitetit për Arsim ka rëndësi, sa shihet në raport ekskursionet nuk janë përshirë pra nuk monitorohen. Pastaj janë konkurset që shpallen pra është një plan copy paste i viteve tjera.

Gentianë Hoti: Nuk e kuptoj pse komiteti me marrë pjesë nëpër konkurse, kur janë komisionet për ato punë.

Veton Zogaj: Nuk thash me pas rolin e komisionit, por me kanë monitorues, unë me dashamirësi thash në përgjithësi me dal përtej asaj të kaluarës, si për shembull me filluar me platformat online.

Argjend Thaçi: Kush jeni për rekomandim të kësaj pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

7. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa Nr.02/277 datë: 03.06.2022 e parashtruar nga z.Enver Zenel Mazreku nga Malisheva, për këmbimin e pronës private me prone publike.

Argjend Thaçi: Ne pas shqyrtimit të kësaj kërkesë të parashtruar pranë këtij organi, përmes kësaj shkrësë përcjellëse nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoro-Juridik dhe Drejtoria për Urbanizëm po kërkojmë Raport me informacione-sqarime shtesë lidhur me kërkesën e lartcekur.

Unanimisht ishin për.

Kërkesa Nr.02/190 datë: 15.04.2022 e parashtruar nga kryesia e fshatit Bellanicë.

Argjend Thaçi: Ne pas shqyrtimit të kësaj kërkesë të parashtruar pranë këtij organi, përmes kësaj shkrësë përcjellëse ne po kërkojmë nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoro-Juridik dhe Drejtoria për Urbanizëm informacione-sqarime shtesë lidhur me kërkesën e lartcekur.

Unanimisht ishin për.

Kërkesa Nr.01/258 datë: 23.02.2022 të parashtruar nga zj. Valmire Gashi nga fshati Vermicë, Komuna e Malishevës, për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike, për ngritjen e biznesit familjar me qëllim të sigurimit të kushteve ekonomike për jetë.

Argjend Thaçi: Ne pas shqyrtimit të kërkesës së lartcekur, përmes kësaj shkrësë përcjellëse unanimisht po kërkojmë nga Kryetari i Komunës që në lidhje me kërkesën e lartcekur të bëjë zbatimin e procedurave të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Veton Zogaj: Ky person ka operuar si biznes aty kas pas telashe edhe më herët aty, duhet ankand publik.

Unanimisht ishin për.

Kërkesa Nr.02/252 datë: 23.05.2022 të parashtruar nga z. Besnik Bytyqi, person i autorizuar i Lagjes së mjekëve (Shabanhajdinëve), për rregullimin e murit të varrezave në fshatin Shkozë.

Veton Zogaj: Duhet sqarime shtesë nga drejtoria e Urbanizmit.

Argjend Thaçi: Ne pas shqyrtimit të kësaj kërkesë të parashtruar pranë këtij organi, përmes kësaj shkresë përcjellëse nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoro-Juridik dhe Drejtoria për Urbanizëm po kërkojmë informacione-sqarime shtesë lidhur me kërkesën e lartcekur.

Unanimisht ishin për.

Kërkesa Nr.02/134 datë: 21.03.2022 të parashtruar nga kryetari i Lagjes Shala nga fshati Banjë, Komuna e Malishevës.

Argjend Thaçi: Ne pas shqyrtimit të kësaj kërkesë të parashtruar pranë këtij organi, përmes kësaj shkresë përcjellëse nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoro-Juridik po kërkojmë që të bëjnë trajtimin e mëtutjeshëm dhe zhvillimin e procedurave të kërkesës në fjalë.

Unanimisht ishin për.

kërkesa nr.02/131 datë: 21.03.2022 të parashtruar nga z.Hamdi Kastrati nga fshati Zatriq Komuna e Rahovecit, drejtori i "Zatriqi" sh.p.k, për marrjen e Pëlqimit për shfrytëzimin e gurit gëlqeror.

Argjend Thaçi: Andaj pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, përmes kësaj shkresë përcjellëse nga Komiteti për Politikë dhe Financa prej Kryetarit të Komunës kërkohet që të bëjë trajtimin e mëtutjeshëm dhe zhvillimin e procedurave.

Unanimisht ishin për.

Kërkesa Nr.02/272 datë: 02.06.2022 e parashtruar nga z. Besart Shala nga fshati Banjë, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare, për trajtim shëndetësor të vajzës së tij Nina Shala.

Argjend Thaçi: Kemi këtë kërkesë pasi që gjendja shëndetësore e asaj vajzë është mjaft e rëndë dhe është duke u trajtuar jashtë shteti, nëse jeni dakord e rekomandojmë për Kuvend. Kush jeni për rekomandim të kësaj pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për.


8. Të ndryshme

Argjend Thaçi: Nëse nuk kemi diçka ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13.10

Procesmbajtësi

Naim Avdiqaj jur. i dip



Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi

